



ASSE NEWSLETTER
NR. 8
Janar 2014

Çështje me interes

Urimi i fillimvitit

Konferenca e dymbëdhjetë e ESSE-s

Lajme nga ESSE

Kuotizacionet për 2013

Thirrje të reja për *in esse*

Cfps

Urimi i fillimvitit

Të dashur miq!

Në radhë të parë dëshiroj që ky vit të jetë i mbarë për të gjithë ju, për familjet tuaja si dhe për njerëzit tuaj më të dashur. Qoftë ky një vit i mbarë edhe profesionalisht!



Ky vit për ASSE-n është viti i përgatitjeve të aktiviteteve të rëndësishme, ndër të cilat janë konferenca e tretë e ASSE-s, e cila do të mbahet në pranverë të vitit 2015, dhe dy numrat e revistës shkencore *in esse: English Studies in Albania*. Në këtë kuadër, dëshiroj t'i ftoj të gjithë anëtarët të ndajnë mendimet dhe sugjerimet e tyre të vyera për tema interesante për këto aktivitete.

Në një plan më ndërkombëtar, aktiviteti më i rëndësishëm për këtë vit është konferenca e dymbëdhjetë e ESSE-s, e cila do të zhvillohet në Kosice të Sllovakisë. Për këtë arsye, kam parapëlqyer që në vend të një kartoline urimi të vendos posterin lajmërues të aktivitetit.

Duke ju uruar edhe një herë një vit të mbarë.

Me respekt,
Armela

Në këtë numër:

Kartolina e urimit 1
Konferenca e dymbëdhjetë e ESSE-s 1

Konferenca e dymbëdhjetë e ESSE-s

ESSE organizon konferencën e saj të dymbëdhjetë në Kosice të Sllovakisë në datat 29 gusht -2 shtator 2014. Siç e dini konferencat e ESSE-s janë ndër aktivitetet më të rëndësishme që zhvillohen në studimet në

Lajme nga ESSE	2	gjuhën angleze. Format i tyre është më i gjerë se formati i konferencave të zakonshme, duke ngërthyer në vetvete tematika më specifike të trajtuara në seminare, tavolina të rrumbullakëta, sesione për studentë doktrate, seanca plenare dhe nënplenare me tematikë të caktuar. Me këtë rast, dëshiroj t'ju kujtoj se afati për dorëzimin e propozimeve tuaja për seminare, tavolina të rrumbullakëta dhe sesione për studentë doktrate është 28 shkurt 2014 . Për më shumë informacion, klikoni në http://kaa.ff.upjs.sk/en/event/4/12th-esse-conference .
Kuotizacionet për 2013	2	
Anëtarësimet e reja <i>in esse: English</i>	2	
<i>Studies in Albania</i>	3	
Thirrje të reja për <i>in esse</i>	3	
Cfps	4	

Lajme nga ESSE

Siç jeni njoftuar edhe më parë, ESSE tashmë ka zyrtarisht një sekretare dhe drejtor thesari të ri. Pas votimit që u krye në mbledhjen e bordit të ESSE-s në Kluzh, Rumani në 29-30 gusht 2013, sekretare e ESSE-s u zgjodh Prof. Smiljana Komar, Universiteti i Ljublanës, Slloveni, kurse drejtor thesari u zgjodh Prof. Alberto Lázaro, Universiteti i Alkalásë, Spanjë. Të dy kanë mbajtur poste të ndryshme drejtuese dhe administrative të rëndësishme në institucionet e tyre, në shoqatat kombëtare dhe në ESSE.

Për më shumë të reja nga ESSE, ju lutem konsultoni vazhdimisht faqen e saj zyrtare, <http://www.essenglish.org/>.

Kuotizacionet për 2013

Njoftohen të gjithë anëtarët e ASSE-s se duhet të shlyejnë detyrimin e tyre vjetor përkundrejt shoqatës brenda periudhës qershor 2014. Kuotizacioni është i njete si në vitet e mëparshme dhe përfshin: 1) anëtarësimin në ASSE, 2) anëtarësimin në ESSE, 3) tarifa konference të reduktuara si në konferencat e ASSE-s, ashtu edhe ato të ESSE-s, 4) të drejtën e botimit në *in esse*.

Detajet do t'ju komunikohen të gjithë anëtarëve të ASSE-s me e-mail.

Anëtarësime të reja

Dëshirojmë t'ju kujtojmë të gjithë të interesuarve se procedurat e anëtarësimit në ASSE përcaktohen në nenet 4 dhe 5 të statutit të shoqatës. Më poshtë do të gjeni këto nene.

Neni 4 – Anëtarësimi

ASSE është shoqatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e hapur për të gjithë ata kërkues, mësimdhënës, specialistë të studimeve të gjuhës angleze që punojnë në nivelin universitar në Shqipëri. Shoqata mirëpret gjithashtu të gjithë ata kërkues,

mësues e specialistë ndërkombëtarë që punojnë dhe kontribuojnë për nxitjen e këtyre studimeve në Shqipëri.

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga dy kategori:

Anëtarët e thjeshtë me të drejta dhe detyrime të plota: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues, mësimdhënës të gjuhës angleze që operojnë në nivelin universitar përmes aktivitetit të tyre.

Anëtarë nderi: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata njerëz dhe personalitete me kontribute të veçanta në studimin e anglishtes në Shqipëri. Statusi i anëtarit të nderit propozohet nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohet në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit çlirohen nga detyrimi i kuotës së anëtarësimit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta me anëtarët e thjeshtë të ASSE-s.

Neni 5 – Procedura e anëtarësimit

Çdokush me interesa profesionale e shkencore në studimet angleze që punon në nivelin universitar mund të aplikojë për tu anëtarësuar në ASSE. Për tu anëtarësuar, personat që dëshirojnë të bëjnë pjesë në ASSE duhet fillimisht të plotësojnë një formular elektronik, i cili përmban pyetje që verifikojnë statusin e aplikantit dhe provojnë njohjen e tij me statutin e ASSE-s. Të drejtën për miratimin e aplikimeve për anëtarësim e ka Këshilli Drejtues. Pas anëtarësimit, këta persona duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit dhe të regjistrohen në listën e anëtarëve. Përrjashtohen nga kuota e anëtarësimit anëtarët e nderit të shoqatës.

in esse: English Studies in Albania

Buletini i përvitshëm i ASSE-s *in esse: English Studies in Albania* po ecën në një rrugë të mbarë. Janë tashmë 6 numra të botuar nga ky buletin, dy për vitin 2010 (Spring, Autumn), dy për vitin 2011 (Spring, Autumn), me punime nga konferenca e parë e ASSE-s dhe dy për vitin 2012 (Spring, Autumn). Ndërkohë është duke u punuar për numrin e parë dhe të dytë 2013, të cilat përmbledhin punime nga konferenca e dytë e ASSE-s. Ftojme të gjithë anëtarët e ASSE-s të dërgojnë propozimet e tyre pas daljes së thirrjeve për dy numrat e 2014 në armelap@assenglish.org.

Të dhënat për numrat e botuar të *in esse: English Studies in Albania* si dhe thirrjet e reja për dorëzim artikujsh do t'i gjeni në faqen <http://www.assenglish.org/publications/>.

Ftesë për ide për thirrje të reja për *in esse: English Studies in Albania* (Spring, Autumn 2014)

Të dashur miq!

Është koha që të bëjmë planifikimin për thirrjet e reja për buletin e ASSE-s. Me këtë rast, ftoj të gjithë anëtarët që të sjellin idetë e tyre të shtjelluara në një paragraf (rreth 200-250 fjalë) për të për zgjedhur ato ide që duken më interesante për dy numrat e 2014 *in esse: English Studies in Albania*.

Të gjitha propozimet do të nisen në dokument Word në adresën armelap@assenglish.org. Pas afatit të dorëzimit të propozimeve, ato do të shqyrtohen nga bordi, i cili do të marrë vendimin se cilat propozime do të zhvillohen në thirrje për artikuj për numrat e 2014.

Afati i dorëzimit të propozimeve: 31 mars 2014.

Afati për shqyrtimin e propozimeve: 15 prill 2014.

Call for papers



CALL FOR PAPERS

Balkans in Contemporary Travel Writing

Faculty of Philosophy, University of Montenegro

Nikšić, June 19-21, 2014

In her seminal study *Imagining Balkans* Maria Todorova observed travellers and travel writers have always been the first to make communicative links between various political, cultural, and geographical units and parts of the world, and therefore, they have also been the first interpreters of the travelled world. As much as travel writing tells about that world, the heritage of travel writers mirrors the conceptual world that initiated their travels, providing fertile ground to investigate the question of why the “other” appears exactly as it does through the traveller’s perspective. As we have witnessed abrupt changes in the region in the last two decades, our conference will be devoted to the analysis of travel writing created during this period. We invite scholars to join us and contribute with their innovative papers to our efforts, so that together we may explore this challenging theme.

We are pleased to announce that our key-note lecturer will be Professor Vesna

Goldsworthy, Professor of English Literature and Creative Writing at the Kingston University, London, the author of the seminal book for our studies *Inventing Ruritania: the imperialism of the imagination* (1998).

The deadline for applications is March 31, 2014.

Your proposals, containing an abstract no longer than 300 words, with up to 8 key words and a short CV, should be sent to Marija Krivokapić Knežević (marija13a@gmail.com).

For the Organizing Committee,
Dr. Marija Krivokapić Knežević

For the Academic Committee,

Dr. Aleksandra Banjević, University of Montenegro
Dr. Bojka Đukanović, University of Montenegro
Dr. Miloš D. Đurić, University of Belgrade
Dr. Marija Krivokapić Knežević, University of Montenegro
Dr. Armela Lučić Zoranić, International University of Novi Pazar
Dr. Aleksandra Nikčević-Batrićević, University of Montenegro
Dr. Armela Panajoti, University of Vlora
Dr. Petar Penda, University of Banja Luka
Dr. Aleksandra Saržoska, University of Skopje

15 janar 2014

“LETËRSIA KRIJUESE DHE QASJET KRITIKE NDAJ LETËRSISË”

Tetovë, 25-26 prill 2014

SHPLLJE PËR HULUMTIME SHKENCORE

Kemi nderin dhe kënaqësinë të shpallim Konferencën e Parë Ndërkombëtare me temë mbi Letërsinë Artistike dhe qasjet kritike ndaj letërsisë, në Universitetin e Europës Juglindore, e cila do të mbahet në 25-26 prill 2014.

Shekulli XXI ka prodhuar sfida të reja të cilat janë shprehur nga letërsia artistike-terrorizmi, kolapsi ambiental, ndërrimi i roleve të gjinive, si dhe kriza botërore ekonomike. Rrjedhimisht, ne ftojmë autorë të cilët do të dëshironin të dorëzojnë propozime për hulumtime shkencore në të cilat në mënyrë analitike të diskutohen aspektet e praktikës artistike, të menduarit artistik, si dhe qasjet në letërsi

artistike, sidomos në raport me shkrimin bashkëkohor artistik.

Gjithashtu, në këtë konferencë do të trajtohet edhe një vistër i gjerë temash, të cilat do të ngërthejnë:

- Qëndrimet bashkëkohore ndaj problemeve bashkëkohore
- Koncepti i letërsisë botërore
- Estetikë
- Mjeshtëria e të shkruarit
- Promovimi i veprave letrare - Metanalizë e librave beletristikë.

Nënkuptohet se kjo konferencë mund të përfshijë edhe tema të tjera, varësisht nga cilësia dhe numri i hulumtimeve të dorëzuara.

Kjo konferencë do t`u mundësojë shkrimtarëve t`i krahasojnë interesimet dhe arritjet e tyre letrare si dhe të reflektojnë përvojat dhe qëndrimet e tyre ndaj letërsisë artistike.

Konferenca përbëhet nga sesione të ndryshme, të cilat do të përqendrohen në së paku një nga temat e lartpërmendura.

UEB FAQJA E KONFERENCËS,
<http://www.seeu.edu.mk/sq/research/announcements?id=986>.